



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë më 6.11.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Prezantimi i projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019” *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka, Vullnet Sinaj dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Erion Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi – Drejtor i buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Suzana Stefa – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Doris Andoni - përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëdita, të nderuar deputetë!

A ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së shkuar? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në axhendën e ditës së sotme me të cilën hapim siparin e diskutimeve për buxhetin e vitit 2019.

Sot do të kemi prezantimin e buxhetit. Relator është zoti Besnik Baraj. Ky buxhet do të shqyrtohet në parim në seancë parlamentare të datës 22 nëntor 2018 dhe pastaj, respektivisht, me datën 3 dhjetor do të miratohet nen për nen.

Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Sot kemi ftuar ekipin e Ministrisë së Financave, kryesuar nga zëvendësministri, zoti Erjon Luçi, të cilit i uroj mirëseardhjen bashkë me ekipin.

Urdhëroni për procedurë, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj - Faleminderit!

E kisha lidhur me vijimin e kalendarit të diskutimeve. Sot që ka ardhur zoti Luçi, do të trajtojmë vetëm pjesën e Ministrisë së Financave, apo edhe ndonjë pjesë të Ministrisë së Ekonomisë? Pra, do diskutojmë për pjesën që lidhet me fondin e inovacionit, fondin e startup-eve, apo do të lemë një seancë më vete, ku të vijë e njëjta ministri, por për pjesën zhvillimore, jo për pjesën makro dhe buxhetore?

Si ndihen përfaqësuesit e ministrisë? A janë komod ta bëjmë me të njëjtët persona apo ka një grup tjetër që mund të jetë më i specifikuar?

Erjon Luçi – Mirë do të ishte që sot ta diskutojmë thjesht në parim, pra konturet e përgjithshme të buxhetit. Për sektorë të veçantë do të përqendrohemi veçmas, meqenëse kemi edhe Franin këtu, megjithëse te vendorja duhet të kishim edhe përfaqësues nga Ministria e Brendshme, por sido që të jetë, për këta sektorë do të sugjerojë se do të ishte më mirë të kishim edhe përfaqësues të tjerë.

Eduard Shalsi – Dakord.

Zoti Beqaj, do të parashikojmë një mbledhje tjetër.

Atëherë, duhet të theksoj se të enjten tjetër nuk kemi seancë parlamentare, që do të thotë se mund të vijojmë axhendën me mbledhje komisioni.

Ditën e premte kemi të fiksuar mbledhje komisioni me ministrin e Turizmit. Këto dy javë janë të dedikuara, paradite e pasdite, për mbledhjet e buxhetit.

(Diskutime pa mikrofon)

I japim fjalën përfaqësuesit të ministrisë të bëjë një prezantim konciz të buxhetit pastaj do të vijojmë me pyetjet e kolegëve.

Erjon Luçi - Faleminderit!

Më shumë do të përqendrohem te pjesa që s'ka qenë te prezantimet e përgjithshme, sepse një pjesë e ka dëgjuar prezantimin e buxhetit edhe në mbledhjen e kryetarëve, edhe nëpër komisione të tjera.

Unë do të theksoj disa nga elementet kyçe të buxhetit për të kaluar pastaj në detaje.

Ky buxhet ka si synim mbështetjen e rritjes ekonomike, të cilën e kemi parashikua mbi 4% dhe presim të mbetet mbi 4% edhe për vitet e ardhshme. Dua të theksoj se është një rritje mbi mesataren e rajonit dhe ka qenë relativisht nga më të qëndrueshmet pa pasur ulje-ngritje.

Kjo bëhet akoma më sfiduese edhe për faktin që ne tani jemi te cikli i maturimit të disa investimeve të huaja direkte që janë relativisht të mëdha dhe nuk është se janë të përsëritshme në atë cikël që do t'i përdorim ne, por përsëri rritja ekonomike pritet të mbetet në terma të kënaqshme, gjë që do të konvertohet edhe në uljen e papunësisë, ku pritet që numri i të papunëve të shkojë te 12%, shpresojmë edhe më poshtë, nga 12,9% që është aktualisht.

Si buxhet, pavarësisht se janë më shumë terma financiarë, janë terma financiarë që ulin koston.

Dua të theksoj se për herë të parë po mundohemi ta mbajmë deficitin poshtë 1,9%-it, e përkthyer në bilanc primar është plus 0,5% e PBB-së, e thënë ndryshe, ne nuk po i marrim më publikut lekë për shpenzimet e buxhetit, pra nuk po ngremë më borxhin për shpenzimet e buxhetit dhe çdo gjë bazohet tek të ardhurat e krijuara nga tatimet dhe taksat, të ardhurat jotatimore. Pra, ky është një buxhet, i cili prapë ka si objektiv, sidomos në periudhën afatmesme, kapjen e një niveli, që për vende si Italia apo vende të tjera, janë parametra kritikë për të bërë politika ekonomike pak më fleksibël, që është niveli i borxhit poshtë 60% të PBB-së.

Me këtë rregull që ne kemi zbatuar prej disa vitesh jemi në rrugë të mbarë për të kapur atë nivel që para disa vitesh u quajt një shmangie jo e rëndësishme nga maxhoranca, opozita e asaj kohe, por prapë duhet të kujtohesh se 60% është një nivel relativisht kritik për një vend si Shqipëria dhe do të ndihet shumë më tepër rëndësia e kapjes së atij niveli në çastin që interesat e tregjeve ndërkombëtare, sidomos BQE-ja, fillon të ndryshojë kursin e normave të interesit.

Po të shikoni lëvizjet që kanë ndodhur këto kohë në tregjet amerikane, janë shumica të lidhura me normat e interesit ose pritshmëritë për normat e interesit, që tregojnë fuqinë që kanë këto lëvizje të mëdha për shpenzimet tona.

U zgjata pak për të dhënë kontestin e rëndësisë ose të utilitetit dhe të konsolidimit fiskal. Ne shpresojmë që vitin tjetër ta thyejmë edhe 65%-shin e PBB-së, që është një numër i mirë edhe për ata që investojnë në borxhin e Shqipërisë për të mbajtur norma relativisht të ulëta.

Ne vazhdojmë të fokusohemi te sektorët prioritarë që janë arsimi, shëndetësia, dhe në veçanti bujqësia dhe infrastruktura.

Bujqësia, përmes fondit të skemës kombëtare që është 2,6 miliardë dhe IPARD-it që u bë aktiv para ca kohësh dhe thirrja do të hapet në fund të këtij muaji, më 30 nëntor, dhe me skemën e grantit të BERZH-it dhe të qeverisë, mund të ketë një hapësirë financimi që mund të shkojë lehtësisht edhe te 10- miliardëshi, por ideja është se sa mund të absorbohet dhe sa mund të procedohet një hapësirë kaq e madhe që i është krijuar bujqësisë.

Gjithashtu, edhe tek infrastruktura, me gjithë se besoj se do të ketë një seancë më vete, që këtë vit do të mbyllën jo pak akse dhe projekte, që është një arritje relativisht e mirë në aspektin e konsolidimit të portofolit dhe rritjes së eficiencës së punëve publike, vitin tjetër synohet pikërisht avancimi dhe mbyllja, mundësisht brenda vitit 2020, e akseve kryesore kombëtare të infrastrukturës, përfshi edhe aktivizimin e projektit 1 miliardë euro të koncesioneve dhe të PPP-ve që tani është më i avancuar.

Shpenzimet e personelit mbahen të kontrolluara, por megjithatë do të ketë një rritje pagash, ku do të përfitojnë 4650 mjekë, 13765 ndihmësmjekë, 35700 mësues, 6800 ushtarakë, 3559 efektivë të Policisë së Burgjeve, si dhe 308 diplomatë.

Pavarësisht se te pjesa e pagave dhe personelit është akomoduar edhe reforma në drejtësi, e cila ka një efekt jo të vogël në paga, si dhe reforma të tjera, përfshi edhe atë të zgjerimit të forcave së policisë para ca kohësh, prapë është bërë i mundur një axhustim dhe mbajtja e disa sektorëve pak më kompetitivë, sidomos ndaj presioneve që mund të ketë në rrjedhjen stafit.

Gjithashtu, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes arrijnë një nivel relativisht të mirë, nga 48,6 miliardë dhe këto janë të fokusuara sidomos te rrjeti rrugor kombëtar, te sistemet e teknologjisë dhe të informacionit, përveç skemës së mbështetjes së fermerëve.

Për rrjetin rrugor Kombëtar ka një projekt relativisht të avancuar të BB-së, që ka kontraktuar një pjesë të firmave për pjesën e Veriut dhe planifikohet i njëjti standard edhe për

pjesën e Jugut të Shqipërisë, që do ta vendoste edhe mirëmbajtjen e rrugëve në një sigurim cilësisë dhe të pritshmërive që krijohen nga shpenzimet që shkojnë në mirëmbajtje.

Subvencionet parashikohet të ulen në 1,5 miliardë të PBB-së, rreth 0,1% e PBB-së. Kjo vjen kryesisht prej faktit që subvencionet janë menduar të ndahen në dy pjesë, pak me shumë se gjysma e subvencionit të shkojë për investime dhe të mos shkojë më për shpenzime operative që shumica ndër këto vjet ka shkuar për të paguar faturat e energjisë.

Kështu pra, kemi filluar të lëvizim drejt një subvencioni që të jetë pak më i lidhur me performancën, gjë që duam ta bëjmë pak më të formë me grantin e qeverive lokale, pavarësisht se do ketë diskutim për këtë, por për momentin do të shfrytëzojmë vetëm grantin që japim për vit.

Te skema e sigurimeve shoqërore vlen të theksohet se parametrat janë mbajtur nën kontroll për ato skema të cilat mund të jenë duke rrëshqitur pak. Kemi vendosur limite, për shembull për rimbursimin e barnave, edhe për paaftësinë kemi vendosur disa tavane dhe po mobilizojmë asistencë edhe me BB-në dhe me të tjerë për të përmirësuar këto skema që të mos dalin jashtë kontrollit. Nevojat gjithmonë janë në rritje, por gjithmonë duhet të ketë një balancë mes nevojave në rritje dhe buxhetit, duke pasur parasysh edhe trendin në rritje që kanë pasur këto skema prej vitesh, pavarësisht nga një farë kontrolli që është ushtruar gjatë viteve të fundit.

Unë mund të hyj sektor për sektor që të jap një panoramë për të parë ku janë targetet.

(Diskutime pa mikrofon)

Po bëj një panoramë të strukturës së bujqësisë, pastaj me kërkesën tuaj mund të bëj edhe një përmbledhje të sektorëve të tjerë, pavarësisht se shumica e gjërave janë të sqaruara.

Pra, siç jua thashë, tek infrastruktura përparësi mbetet shtyrja e projekteve ekzistuese, mundësisht mbyllja e tyre për t'i bërë efektive për të pasur një kthyeshmëri ekonomike. Ne do të vazhdojmë me akset rrugore nacionale si Rruga e Arbrit, Thumanë-Vorë, Kashar-Milot-Balldren, Orikum-Dukat, pasi të gjitha këto janë pjesë e projektit 1 miliard...

Eduard Shalsi – Këto janë parashikuar të fillojnë në vitin 2019, apo jo? Rruga e Arbrit ka filluar, po rruga Thumanë-Kashar-Rrogozhinë?

Erion Luçi – Një pjesë e tyre ka filluar, ndërsa këto të tjerat janë duke u finalizuar si kontrata, por shpresojmë që shumica e tyre do të fillojnë vitin tjetër, pasi kanë një nxitje për t'i filluar sa më shpejt punimet, për të kapur pjesën e pagesave. Në vazhdim do të jenë edhe rrugët Kardhiq-Delvinë, lotet 4, 5, 6, 7 dhe 8, Fushë Krujë-Milot-Morinë, Qafë Thanë-Lin-Pogradec. Unaza e Tiranës do të ketë goxha...

(Diskutime pa mikrofon)

Lin-Pogradec ka disa lekë të vogla, pasi ka ngelur një pjesë shumë e vogël pa u bërë. Praktikisht ajo si rrugë ka mbaruar...

(Diskutime pa mikrofon)

Ka shumë pak lekë të mbetura për vitin tjetër, por në aspektin total ka mbaruar.

Unaza e Tiranës, siç e keni parë edhe këto ditë është në qendër të vëmendjes, sidomos pjesa verilindore, pallati me shigjeta, si dhe te rrethrotullimi i Shqiponjës, që marrin gati 1,9 miliardë këtë vit dhe vitin tjetër, prandaj kjo pjesë do të jetë goxha në fokus.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Është një situatë psikologjike Shqiponja dhe pjesa tjetër...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk ka filluar ende.

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Luçi – Më pas janë *bypass*-i i Tepelenës, fillimi i tunelit Kardhiq-Delvinë, një projekt tjetër i rëndësishëm është ai i hekurudhës Tiranë-Durrës, të cilin jam duke e ndjekur ditë pas dite, përveç financimit që është shumë pozitiv, gjë të cilën e kemi diskutuar në këtë komision dhe që lidhet edhe me aeroportin dhe më pas janë dy *bypass*-et, të cilat jua lexova sot, ku më fund u shpallën edhe kontratat për *bypass*-in e Fierit dhe të Vlorës me shpresën që vitin tjetër të ketë një korsi të hapur në mënyrë që të aktivizohet Korridori i Jugut.

Nëse këto si projekte arrijnë të kenë një avancim të mirë rreth 2020 do të krijohet një bazë e mirë për lehtësimin e transportit dhe për uljen e kostove të lëvizjeve nga Veriu në Jug, sidomos në pjesën Tiranë-Durrës nëse ky aks zgjerohet...

Në fakt, aksi Tiranë-Durrës nuk është i paraqitur këtu, është vetëm hekurudha, pasi është në projektin tjetër që po diskutohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon bujqësisë, jua thashë edhe më lart, është një vit relativisht sfidues për absorbimin e fondeve, prandaj edhe unë jam nën presion si pjesë e zyrtarit kombëtar autorizues për absorbimin sa më shumë të fondeve të IPARD-it, pasi janë gati 50 milionë euro që mund të merren, të cilat janë para falas, ku skema kombëtare ka arritur nivelin 2,9 miliardë, ndërkohë që vazhdon aktivizimin edhe garancia e BERZHI-t me qeverinë për dhënien e kredive që mund të fillojë nga aktivizimi vitin tjetër.

E rëndësishme, sidomos në bujqësi, është se si të gjesh mënyrat përtej skemave qeveritare, të kapësh sidomos fermerin e vogël edhe për të bërë projekte dhe për ta supervizuar sa më mirë. Sa i takon pjesës së IPARD-it, janë fonde për të cilat duhet të tregojmë edhe një farë kualiteti, nuk është thjesht çështja ta ndihmosh me një financim dhe

më pas të mos e ndjekësh më, prandaj qëndrueshmëria e investimit dhe modernizimi si sektor janë shumë të rëndësishëm. Bujqësia ka një vit relativisht sfidues sa i takon vitit që vjen, përtej programeve standarde të rritjes...

Eduard Shalsi – A keni ndonjë të dhënë nga shuma që është alokuar vjet, se sa janë absorbuar në buxhet deri tani?

Erion Luçi – Me shifra faktike është pak e ulët, por nga ana e ministrisë thuhet se pritshmëria do të arrijë gjysmën e asaj që është alokuar...

Eduard Shalsi – Gjysma e asaj që është alokuar, çka do të thotë se mbetet një sfidë shumë e madhe për vitin tjetër, sepse jemi në të njëjtat nivele, apo jo?

Erion Luçi – Unë po e analizoj vetë QKZHBR-në, sepse më duhet ta konfirmoj si bankë të DG Arbri, por t'ju them të drejtën prapë këto struktura duhen...

Eduard Shalsi – Kam 2-3 meraqe nga pikëpamja financiare. Ne jemi informuar për një portofol të këtyre bankave dhe jo bankave, institucioneve, që shkon rreth 150 milionë euro. Pra, institucionet financiare kanë kredituar në fushën e bujqësisë rreth 140-150 milionë euro me interesa të ndryshme, shpeshherë të frikshme. Ne kemi dëgjuar për interesa 18-19%, ndërsa Pjetri na tha për 22%, siç ishte rasti i një fondacioni apo NGO-je.

Dua një informacion mbi kredidhënien e këtyre institucioneve, a është realisht 140-150, si dhe nivelin e interesave që ato aplikojnë?

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, nuk janë kredi të këqija, por ky është portofoli i kredive nga institucione financiare, jo banka. Kam përshtypjen se nga ato që u thanë ishin jo banka, por kjo duhet parë dhe nuk e di nëse ekziston ky informacion edhe te Banka e Shqipërisë në lidhje me portofolin e bujqësisë nga sistemi i nivelit të dytë të bankave, por të dyja duhen parë. Arsyeja pse duhen parë është kjo tjetra, nëse këto institucione financojnë shifra të tilla 140-150, atëherë duhet të shohim mundësinë e kompensimit me interes financiar, ndërkohë që ne po financojmë 50% të skemës. Pra, duhet të gjejmë disa mënyra.

E para, nëse mund t'i kontrollojnë këto interesa, sepse për mua është e paimagjinueshme se si mund të merret një kredi me 90% në sektorin bujqësor dhe të kthehet me 15, me 16 me mbi 1 *break in verpoint* kredia e marrë ka nonsens. Na duhet një informacion nga këto institucione, banka dhe jo banka në lidhje me bujqësinë.

E dyta, këtë çështje do ta shtrojmë më fort dhe nuk e di nëse do të mund të ndikojmë në buxhetin e këtij viti, por personalisht do ta bëj këtë betejë. Të dhënat në sektorin e bujqësisë janë jo të besueshme, mbi të cilat ne ngrejmë një vendimmarrje dhe ndoshta edhe ju si përfaqësues i ministrisë do të mund të ndërgjegjësoni edhe ministrinë, edhe qeverinë për

rëndësinë e bazës në të dhëna. Për hir të së vërtetës, ne kemi kërkuar disa informacione dhe për 10 vjetët e fundit nuk ka rekorde, janë disa tabela *Excel*-i të lodhura në AZHBR apo në Ministrinë e Bujqësisë. Pra, si mund të pretendojmë ne të ecim me mbështetje pa folur më pas për rezervat që kemi për kthimin e IPARD-it dhe se sa koshient janë jo ata që do ta marrin, por ata që do t'u shpjegojnë atyre që do ta marrin, sepse sot që jemi duke folur nuk janë fare koshient dhe të ndërgjegjshëm.

E gjithë kjo skemë financimi duhet analizuar mirë përpara se ta miratojmë. Ne nuk jemi të bindur nëse duhen apo jo 2,6, aq sa ishte vjet, ndërkohë që duhet bërë një analizë e mirë pse nuk janë marrë ato. Unë do të doja që ju ta mbanit shënim çështjen e financimit me interesa të larta të sektorit bujqësor nga institucionet jo banka, si dhe të bëni një analizë të mirëfilltë për të parë se ku mund të ndërhyhet, sa mund të ndërhyhet, çfarë mund të bëjmë?

(Diskutime pa mikrofon)

Një pjesë mund të largohet, ndërsa pjesa tjetër të rrijë.

Kalojmë te pyetjet.

Erion Luçi – Kam përshtypjen se ajo që u bë për mikrokreditë për t'i futur në skemë kishte pikërisht këtë, por duhet *double chek*-u, prandaj nuk mund t'ju them dot me siguri sa është ajo e mikrokredisë, por ka pasur një rritje të depozitave dhe për rrjedhojë edhe të kreditimit. Shifra 150, më duhet ta shoh, ndërsa bankat janë aktivizuar. Një fermer, të cilin e pyeta vetë, por mund t'ju them se edhe vetë norma me garancinë e BERZHI-t dhe të qeverisë shkon te 4,5% për fermerë pak të mëdhenj...

Eduard Shalsi – Sa për qind është përdorur?

Erion Luçi – Është përdorur 4,5%, e cila është një normë goxha e mirë.

Eduard Shalsi – Një normë goxha e mirë për garanci, por që nuk është përdorur.

Erion Luçi – Në krahasim me 18%, por bankat nuk besoj se janë hapur shumë, pasi kanë kosto për njësi goxha të mëdha, prandaj përdoren skemat për t'i nxitur. Kam përshtypjen se mikrokredia ka pasur një rritje, por si informacion më duhet ta përgatis, sepse është interesant për të parë nëse ka funksionuar si reformë, apo jo. E gjithë ideja ishte që të rritej aksesin i bujqësisë...

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Është hera e parë që ia kërkojmë Ministrisë së Financave, pasi ua kemi kërkuar institucioneve të tjera.

Kalojmë te pyetjet apo keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Erion Luçi – Kisha diçka për qeverinë vendore, ku përveç rritjes relativisht të fortë dhe mbi mesataren e buxhetit që vazhdon të aplikohet në aspektin e fondeve, ku ne e kemi të qartë që gjithmonë ekziston një *gap* financiar për funksionet, por të paktën aplikimi i 1%-t të PBB-së për rritjen e grantit të pakushtëzuar plus aktivizimi i taksës së pronës dhe i kadastrës fiskale që është duke ecur mirë, shpresonim pak më shpejt, por e rëndësishme është që po ecën, do të krijojë një rritje goxha të fortë rreth 11% të zarfit të qeverive vendore.

Sa i takon vitit tjetër, do të theksoja se përtej rritjes së burimeve dhe shpërndarjes, që është pak a shumë e standardizuar, e cila me anë të formulave është rishikuar, tashmë po vazhdojmë edhe me pjesën e ligjeve dhe të rregulloreve. Sa i takon ligjit të financave vendore, në të përfshihen edhe rastet e falimentimit të qeverive vendore, jam duke folur më shumë që të jemi të përgatitur, nuk po diskutoj ndonjë rast real, por që mund të zbatohet. Për shembull, në sektorin e ujit, në qoftë se ndërmarrjet nuk performojnë mund të zbatohen disa rregulla administrimi.

Çerdhet dhe kopshtet janë të parat ose një prej funksioneve që vitin tjetër do të futen te granti i pakushtëzuar, kuptohet që do të transferohen me buxhet të plotë 4 miliardë e ca që është goxha shifër. Për këtë rast ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me USAID-in për të bërë një kalim nga sistemi për mësues te sistemi për fëmijë, por pa cenuar ata që kanë numra relativisht të vegjël sesa për të ndihmuar Tiranën dhe qytetet e tjera që kanë klasa relativisht të mëdha. Kjo është një shtesë tjetër që i jepet qeverisë lokale për të synuar këtë sistem, sidomos parashkollorin, për të cilin duam të nisim një mbështetje edhe në aspektin e studimit dhe të ndjekjes me një projekt më të saktë, sepse është një hallkë e sistemit të arsimit që nuk është prekur ndonjëherë, por është mjaft e rëndësishme për ta trajtuar me...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, edhe qeveria lokale është relativisht në fokusin e buxhetit.

Eduard Shalsi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Ju me të drejtë thatë që ky buxhet synon mbështetjen e rritjes ekonomike mbi 4%. Një sektor me shumë rëndësi, por që nuk ka marrë vlerën e duhur në rëndësinë ekonomike të vendit është peshkimi, për të cilin parashikohen rreth 342,6 milionë lekë. A mendoni se kjo shifër është e mjaftueshme për ta stimuluar këtë sektor, për të cilin pranohet se është shumë mbrapa? Pyetja e parë.

Pyetja tjetër, e cila lidhet me një shqetësim tonin si deputetë të Tiranës. Parashikohen plane zhvillimi te Shqiponja, Unaza e Re, të cilat u përmendën edhe pak më parë. A është parashikuar ndonjë fond për familjet që do t'u prishen shtëpitë për shkak të projekteve? Atje ka familje, të cilat ndërtimet e tyre i kanë bërë ndoshta prej 30 vjetësh. Pra, a ka ndonjë

vendim qeverie që kur kalon një numër i caktuar kohe ato legalizohen automatikisht, duhet të ketë ndonjë favor që u bëhet? A janë parashikuar këto, sepse ky është një problem social jo i parëndësishëm?

Po shihja vlerat e akorduara për impiantet, incineratorët, është fjala për atë të Elbasanit, të cilit do t'i jepen rreth 2,8 miliardë lekë. Ku do të adresohen këto para? Janë për shkak të investimeve që ka bërë biznesi privat dhe janë detyrime shtetërore ndaj tyre? Me aq sa di unë ishte një afat, një periudhë me një interval kohe që do të bëheshin këto pagesa dhe po që se bëhet me 2,8 miliardë njëherazi pothuajse mbulohen të gjitha investimet e bëra aty. Po kështu, në Fier parashihen rreth 4,5 miliardë lekë që do të jepen. Bëhet fjalë për ndërtimin e incineratorit dhe kjo do të thotë se do të bëhet nga shteti, apo është me PPP?

Erion Luçi – Për peshkimin si numër është i saktë, është numër i vogël...

Eduard Shalsi – Këtë gjë mund të na e sqarojë ministri i Bujqësisë.

Erion Luçi - ... por do t'ju thosha se peshkimi është tek ato kategori që mund të përfitojnë nga fondet e tjera që thamë, pavarësisht zërit të veçantë aty që mund të lidhet me një projekt të caktuar të ndonjë të huaji, por asnjëherë nuk ka qenë kaq i fokusuar dhe intensiv, pavarësisht se është një potencial i pashfrytëzuar. Pra, nëse bëhen përpjekje të mira ai mund të jetë pjesë e IPARD-it, përtej pyjeve që është një sektor tjetër që mund të absorbojë jo pak, sepse janë përgatitur jo pak këtë kohë, por edhe peshkimi është një sektor tjetër ideal, i cili do të ishte kandidat për bërjen e propozimeve në aspektin e magazinave ose mund të kenë nevojë për përpunimin e peshkut. Te pjesa e IPARD-it, është edhe pjesa e përpunimit që ka lidhje me fermerët...

Besnik Baraj – Meqenëse jemi te IPARD-i, ju si Ministri e Financave, pavarësisht se mbulohen nga sektorët e tjerë përkatës. A keni parashikuar buxhet për rritje kapacitetesh në mënyrë që të zgjidhet problemi i absorbimit të fondeve, duke pasur parasysh një absorbim shumë të vogël apo një ndihmë financiare për trajnimet? Pra, kam frikë se duke ia lënë vetëm sektorit privat, prapë nuk do të arrihen ato standarde që ne i absorbojmë, duhet futet shteti në lojë për forcimin e kapaciteteve dhe përbërjen e projekteve të përshtatshme që të plotësojnë kriteret.

Eduard Shalsi – Pjesë e programit IPARD, zoti Baraj, janë: komponenti i 94 milionëve, fuqizimi i institucionit dhe kapaciteteve. Këto dy ditë po bëhet një trajnim i financiar nga GIZ- i te hotel “Tirana Internacional” për të nxjerrë në pah disa problematika jashtëzakonisht të mëdha për IPARD-in. Konkluzionet e ditës së djeshme, në drejtim të kuptimit të kriterëve nga institucionet dhe zbatimit të tyre, janë shqetësuese. Institucionet nuk i kuptojnë. Të paktën nga takimi i djeshëm ka shumë kundërthënie, është një çështje që do ta

diskutojmë me Ministrinë e Bujqësisë, por brenda fondeve të IPARD-it ka komponentë, që mbase nuk janë të mjaftueshme, por janë parashikuar fonde që shkojnë për trajnime.

Erion Luçi - Sigurinë në aspektin e kapaciteteve dhe të kuptueshmërisë që kanë institucionet do ta jepja unë më shumë se ministri i Bujqësisë. Në fakt, ky është një vit kritik dhe për këtë do të krijojmë një pikë vërtetimi shumë të mirë për të parë ato gepe. Unë e kam parë në praktikë, i kam marrë në intervistë vetë disa nga këto institucione dhe shpresoj që graviteti i fondeve që do të vijnë do të krijojë fokusimin në këtë pjesë. Ne kemi shtuar jo pak stafin e AZHBR-së, vetëm në kohët e fundit shtuam mbi 15 vetë staf, në janar do të ketë 17 të tjerë staf. Gjithashtu, kemi AKU-në dhe Inspektoratin Veteriner që është shumë i rëndësishëm për të kthyer përgjigje në kohë për licencat që do të duhen. Unë mendoj se nuk mungojnë as fondet, as mundësitë, por ta fillojmë një herë, kjo është e rëndësishme. Me fillimin e saj pastaj, pas një viti mund të rriten edhe resurset.

Eduard Shalsi - Po për inceneratorët?

Erion Luçi - Inceneratorët janë investime me PPP, që një pjesë mbulohen nga investimi i bërë dhe pjesa tjetër, një minimum, nga procesimi i mbetjeve që vijnë në incenerator.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Detajet mund t'i sqarojmë edhe më pas, por me aq sa e kam ndjekur unë një proces, që edhe operon, edhe ndërton pagesat nuk dallojnë nga njëra-tjetra, thjesht në çastin që do ta ketë mbaruar, dorëzon një pjesë të caktuar dhe proceson një pjesë të caktuar, do të paguhesh me kaq, si për shembull 17 shkollat e Tiranës, ku u paga një *fee* për menaxhimin dhe operimin e shkollës.

Besnik Baraj - Ç'pjesë shkon për *bill* dhe ç'pjesë shkon për transport e të tjera?

Eduard Shalsi - Në rastin konkret na bëni një paraqitje skematike të financimeve.

Ju përmendët shkollat e Tiranës, për të cilat është e qartë se do të paguhet një *fee* vjetore nga buxheti i bashkisë për një numër të caktuar vitesh. Në rastin konkret pyetja e zotit Baraj ka të bëjë me faktin që nëse këtu po paguhet i gjithë investimi, sepse aq është paguar. Pra, na thoni cilat janë termat e PPP-së në mënyrë skematike? Pra, investimi është kaq, është bërë kaq, po financohet kaq, mbetet edhe kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Luci – Infrastruktura është një farë ndarjeje. Mbetjet janë te infrastruktura.

Për legalizimet dhe shpronësimet kjo është një tjetër absorbim i atij risku që ka qenë edhe më përpara. Strasburgu e quajti të aplikuar mirë ligjin. Ne kemi vënë gati 5 miliardë për 10 vjet, pra duhet për të mbyllur koston 1 miliard euro nga 10 miliardë që ishte parashikimi

filleshtar dhe po e bëjmë të transferueshme edhe për vitet e tjera. Duke pasur parasysh këtë ecuri, fondi që pritet të konsolidohet tani, veç kësaj të pronave, do të jetë relativisht likuid për të trajtuar edhe të mbeturat. Unë këtë e shikoj si arritje të mirë që ka ulur presionin ndaj Strasburgut. Janë disa të mbetura që prapë ne mund t'i absorbojmë brenda të njëjtit fond 5 miliardë, që prapë kam idenë se do të ketë kursime për të shlyer. Por kjo hyn te politika se si ata prioritojmë, një gjë që nuk e them dot që tani.

Eglantina Gjermeni – Unë kam një pyetje lidhur me pushtetin vendor, meqenëse ju e përmendët pak që me këtë buxhet i jepni mbështetje. Përfitoj edhe nga rasti që është zoti Fran të pyes ku konsiston rritja dhe cilat janë zërat që do të mbështeten sepse buxheti thellon më tej implementimin e reformës administrative territoriale dhe, sido që të jetë, këtë vit është edhe vit zgjedhesh. Pra, ku konsiston realisht rritja e buxhetit dhe me çfarë do të mbështeten realisht bashkitë dhe a kanë ndonjë diferencim në mes tyre apo mbështeten të gjitha njëjloj?

Faleminderit!

Erion Luçi - Në total ka një rritje relativisht të rregulluar me 1%-shin e PBB-së, që ato rriten dhe është jo pak, ne e kemi vënë si minimum dhe nuk mund të biem poshtë asaj vlere, kështu që granti i pakushtëzuar, pavarësisht se ky është grant i kushtëzuar, i pakushtëzuar thashë për arsimin parashkollor, për çerdhet dhe kopshtet, është 4 miliardë. Kështu që do të marrim edhe një mbështetje ekstra nga ajo që ka marrë ministria më përpara, që është një bonus.

Përtej asaj që këtë vit është parë që taksa e pronës në vlerë ka dhënë një ndihmë për të zgjeruar mbështetjen e tyre, ne po mundohemi të harmonizojmë dhe ta bëjmë atë pak më të qendëruar si database, domethënë me kadastrën fiskale, por ato janë të lira. Ligji që kur u miratua në janar i ka dhënë efektet e tij, të paktën Tirana dhe disa bashki të tjera kanë pasur goxha të ardhura pozitive nga taksa e pronës. Ne kemi të paktën 3-4 donatorë, tani kemi vështirësi t'i menaxhojmë, sepse po bëjnë një punë jo të vogël në aspektin e harmonizimit dhe të targetimit më të mirë të këtyre shpenzimeve edhe në bazë të performacës që sapo thatë, në aspektin që të ketë një fokusim tek investimet, por jo vetëm. Një fond që donim ta aktivizonim, pavarësisht se jemi pak mbrapa, është fondi social dhe po mendojmë, që ta aktivizojmë në bazë të kontributit. Nëse qeveritë lokale vendosin 5 lekë për pjesën sociale, ne do ta vendosim si qeveri qendrore një 5 lekë për ta bërë më nxitëse. Kështu që jemi duke punuar në disa fronte për ta bërë qeverisjen lokale pak më të monitorueshme jo në aspektin e kontrollit, por më të përgjegjshme në aspektin e mënyrës së planifikimit, të shfrytëzimit të këtyre fondeve dhe shpërndarjes si në qeverisjen qendrore, por jemi akoma te faza që po ndërtojmë këtë bazë, ndërkohë që po e zgjerojmë. Do të thosha që ka disa shembuj të mirë.

Janë 3-4 bashki që janë përpara në aspektin e dëshirës për të ndjekur dhe bërë punë, si dhe mënyrës për të rritur kapacitetet.

Eglantina Gjermani - Nga kontaktet në bashkitë me qytetarët ata ankohen për faktin që kryesisht investohet në infrastrukturë dhe shumë pak në shërbimet sociale ose në fusha të tjera që prekin më shumë qytetarët, prandaj do të doja një shpjegim më të detajuar nëse e keni marrë në konsideratë këtë gjë me mbështetjen që u bëni këtë vit bashkive dhe a do të ketë diferenca?

Erion Luçi - Te formula ka një pjesë për rishpërndarjen, por sa i përket pjesës sociale unë jam duke u marrë vetë deri diku me Ministrinë e Shëndetësisë, me fondin social si ta aktivizojmë në një farë mënyrë, por që të jetë i vetëforcueshëm, për shembull ne mbulojmë edukatorët ose ndërtesën, por të paktën të ketë një shtëpi pleqsh, dhe t'i themi se ne ofrojmë këtë, por ju mbani pjesën tjetër të shërbimit, për shembull, ushqimin. Pra, ideja është që të dalim me një formulë që të ketë sens praktik, të mos jetë një gjë që e bëjnë bashkitë e mëdha.

Fran Ibrahim – Para reformës nga buxheti i shtetit bashkive u shkante për shembull 30 miliardë në vitin 2014. Sot i gjithë buxheti vendor është 51 miliardë, pra shihet një përmirësim shumë i madh para dhe pas reformës. Reforma ka pasur një efekt shumë të madh. Ne përdorim një formulë të cilën në parim e kemi të ligjëruar te ligji i financave vendore, që ka fleksibilitetin e vet në rifreskimin e të dhënave dhe në politika të vitit.

Njësitë, të cilat nuk kanë mundësi reale për të mbledhur taksa dhe tarifa vendore ne i favorizojmë nëpërmjet një koeficienti që është dendësi e banorëve për kilometër katror, që do të thotë ato bashki që nuk kanë mundësi i stimulojmë me një koeficient të transfertës së pakushtëzuar.

Të ndalemi te shërbimet publike ose problemet sociale. Ne vijmë në këtë buxhet pas një ushtrimi që kemi bërë me projektbuxhetin afatmesëm, që është një ushtrim real, që është bërë në pushtetin vendor ku kemi të unifikuar programe dhe në mes tyre janë disa programe sociale duke filluar me strehimin social dhe me programe të tjera sociale, ku njësitë vendore janë të interesuara të investojnë para për këto programe. Ne jemi duke punuar me donatorë për të pasur tregues të vërtetë performance me qëllim që niveli qendror dhe vendor të jetë një drejtim për politikat sektoriale dhe për politikat sociale dhe të shërbimeve. Nuk jemi në momentin që kemi tregues sa dhe si për çdo program, por jemi në rrugën e duhur për t'i standardizuar. E kemi filluar me arsimin parashkollor, duke vënë një standard dhe do ta vazhdojmë edhe me shërbimet e tjera për të gjetur formulën më të mirë që pushteti vendor të jetë i detyruar të ofrojë shërbimet me një standard të caktuar, për shembull këtë vit kemi ulur

ngarkesën e fëmijëve për një edukatore nga 26 fëmijë për një edukatore në 23 fëmijë maksimale, ndërsa mesatare nga 18 me 13.

Shqetësimi është shumë i drejtë, të cilin me donatorët jemi duke e stabilizuar për ta kthyer në një standard për këtë buxhet dhe ato të viteve të ardhshme.

Ilir Beqaj- Kam një pyetje për rrugën Korçë- Kolonjë që ka nisur prej disa kohësh, a do ta financoni për ta mbaruar se nuk ishte te lista?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së dyti, çfarë do të bëhet sa i përket pjesës së rrugës Librazhd- Tepelenë- Ura e Çerenecit, ku janë hedhur gjysma e lekëve, por nuk përmendet në akset kombëtare. Ajo është e bërë në çakull prej disa vitesh dhe pastaj të nxjerr mbi Bulqizë dhe të lidhë me rrugën e Arbërit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është bërë gjysma.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është pjesa verilindore e Shqipërisë dhe ka potenciale për turizëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto të dyja janë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e di se do të na çosh në park javës tjetër. Nuk shkuam në kohë, sepse pardje u dogjën 7 hektarë dhe nuk shkuam.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk i kam parë detajet, por te pjesa përmbledhëse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Robert Bitri – Sa për qind të transportit mbulohen nga Fondi i Zhvillimit dhe sa nga ministria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo pyetje ka tjetër standard.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Luçi – Për rrugët janë 15 miliardë financime të brendshme dhe 6.5 miliardë financime të huaja. Te financimet e brendshme mund të futen edhe shpronësimet dhe kostot lokale. Fondi Shqiptar është 7 miliardë, por nuk e them dot se sa janë për rrugët, sepse ata kanë në portofol edhe një pjesë të fondit të zhvillimit rajonal, madje kanë edhe disa projekte të tjera, por kryesisht janë për rrugë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po 7 miliardë, ndërsa financime të brendshme janë 15 miliardë dhe 6.5 miliardë janë financime të huaja, këtu flasim vetëm për rrugët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha investimet në total, plus minus, mund të shkojnë te 30 miliardë, sepse Fondi ka edhe projekte të tjera, për shembull projekti i Bankës Botërore në jug për turizmin është për të rritur kapacitetet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, 6.6 miliardë janë fiks, për rrugët flasim gjithmonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë dua të shpreh rezervat në vlerësimin shumë prudent dhe shtrëngues që keni bërë për rritjen ekonomike 2020-2021. Nëse u kthehem deklarimeve publike të shtatorit të vitit 2016, kur doli për herë të parë në publik koncepti i 1 miliard eurove për rindërtim, atëherë është thënë që aktivizimi i plotë i këtij instrumenti të ri do të na çonte në një rritje ekonomike mbi 5% në vit për dy-tre vjet. Nisur nga niveli aktual i zbatimit të kontratës së parë dhe i fazës ku janë tre kontratat e tjera, sepse ju i keni përmendur të katër segmentet që do të shkojnë në këtë paketë, unë besoj që në 2020-ën këto kontrata do të jenë efektive dhe në 2021-shin do të duhet të ishim 5% e lart.

Nëse ju kërkoni të jeni prudentë, sepse gjykoni që nuk ka diçka të qartë se me çfarë mund të zëvendësohet kontributi që ka dhënë TAP-i këta 3 vjetët e fundit, atëherë le ta marrim në kompleks sektorin elektroenergjetik. U lidh kontrata e re që një degë e TAP-it do të shkojë në Maqedoni, ku iu dha edhe leja e detit, por te leja e detit ne do të kemi pjesën tonë tek ai financim. Në vitin 2020 do të jenë efektive investimet në energji diellore dhe po në këtë vitit vërtet Devolli nuk ka më investim, por do të ketë shumë prodhim. Vërtet nuk ka më investim në Kalivaç, që ishte 120 milionë euro, por do të fillojë të prodhojë. Mbas dy vjetësh pjesa e energjisë që do të prodhohet normalisht, po të marr një vit mesatar, nga futja e më shumë veprave energjetike, në funksionim do të japë mundësinë që të balancosh boshllëkun që ka krijuar TAP-i dhe për momentin nuk ka një zëvendësues të qartë të TAP-it. Duke qenë të shtrënguar në këtë vlerësim, ju vetvetiu jeni të detyruar të mbani të shtrënguar të gjitha elementet e tjera. Vërtet është një gjë 64.9 ndaj 13 miliardë eurove dhe një gjë tjetër ndaj 13.5 miliardë eurove, sepse me këta parametra vazhdojnë të gjithë elementet e tjera. Unë gjykoj që në kuadrin makro jeni treguar shumë restriktivë.

Kam një merak, që dua ta ndaj me ju, se e pashë edhe në tabelë. Për mua nuk ka logjikë që PPP-të e shëndetësisë të bllokojnë rregullin e vendosur në ligjin organik të buxhetit, ku kontratat koncesionare nuk duhet të jenë më shumë se 5% e të ardhurave vjetore

të vitit të kaluar. Këtë do të përpiqem ta ilustroj më PPP-në e dializës, sepse është rasti më klasik. Dializa është një shërbim jetik për pacientët shqiptarë dhe financohet me një tarifë unike të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Kështu është financuar edhe përpara se të kishte PPP-në dhe kështu do të financohet edhe nesër nëse sot kontrata e PPP-së anulohet. Kontrata e PPP-së së dializës plotëson 30% të nevojave të Shqipërisë për dializë. Në 70% të nevojave i financojmë me një tjetër tarifë të miratuar nga qeveria të privatët, sepse shtetit i kanë ngelur diku të 15%. Cila është logjika? Nuk është problemi që unë dua ta bëj Rugën e Arbrit sivjet, sepse pres edhe 3 vjet të tjera dhe FMN-ja më thotë: që ti je agresiv në investime, ndërsa dializa është jetike, ata po s'e bënë vdesin.

PPP-ja e *check up* – it, në fillim ishte detyrim ligjor dhe pastaj u bë instrument për t'u zbatuar. Nëse nesër anulon PPP – në e *check up*-it, përsëri e ke për detyrë t'ia financosh në ambulacë me lekët e shtetit.

Me të drejtë ke programuar vitin tjetër PPP-në e laboratorëve. Në shpenzojmë sot për laboratorë, pra ato lekë nuk do t'i shpenzojmë më te spitali, por do t'i shpenzojmë me instrumentin tjetër. Përse duhet t'ia lidhim duart shëndetësisë për këto gjëra?

Më tipike është dializa, ku një seancë kushton 110 mijë lekë me VKM dhe këtu Fondi financon edhe spitalin publik, edhe spitalin privat, edhe koncesionarin me të njëjtën tarifë. Nëse nesër anulohet kontrata me koncesionarin se mund të thotë që nuk e bëj më, sepse nuk më intereson, njerëzve u duhet bërë dializa, sepse vdesin nëse nuk e bëjnë.

PPP-të e shërbimeve kanë vetëm një ndryshim nga një tender afatgjatë, investimi me një tender nuk na ngelet në fund, ndërsa me PPP-të investimi na ngelet në. Kjo është e vetmja diferencë. Unë mendoj se mund të ishte bërë edhe një kontratë prokurimi 10-vjeçare, sepse ligji ynë nuk ka tavan. Me PPP-në e dializës shteti shpenzon më pak, sepse sot lekët e transportit i ka kursyer. Pra, përmirëson cilësinë e shërbimit, shpenzon më pak në *over all* dhe i lidh duart vetes për një gjë që nuk ishte dëshirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani nuk paguhet më për transport. Këto janë shpenzime që janë kursyer.

Ju gjykojeni vetë, nuk e di sesi i keni negociatat, por për mua është gjynah të këtë një shtrëngesë të tillë.

Lexova diçka që më tërhoqi, përse shqiptarët duhet të konsumojmë më shumë duhan vitin e ardhshëm, pra përse parashikoni 200 tonë më shumë në import?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Akoma vlerësohet se ka kontrabandë cigaresh, nuk e kuptova kështu relacionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përsëri do të rritet vitin tjetër akciza.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ai thotë që do të zbulojë më shumë, apo ashtu e ka programuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Programimin e çekut të bebeve e keni me shumë tepricë, sepse programoni 30 mijë lindje në vitin 2019, aq sa ka qenë në vitin 2017, por 9-mujori i këtij viti është 18 mijë. Kjo do të thotë se viti 2019 nuk mund të ketë më shumë se 25 mijë lindje, sepse ka pesë vjet që është në rënie. Politika e re mund të japë efekt në korrik e mbrapa, sepse ato që do të lindin deri në qershor nuk e dinin që do të ishte kjo politikë e re. Për vitin e ardhshëm keni parashikuar 2 miliardë lekë për 30 mijë lindjet, që mendoj që janë shumë, sepse 6 muajt e para kanë nisur, për vitin e ardhshëm ngelen vetëm 6 muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vitin e ardhshëm de fakto do të paguhen 11 muaj, sepse kush do të lindë më 20 dhjetor do t'i marrë janarin e vitit tjetër. Aty do të ngelen 700 milionë kot, prandaj çojini në një vend tjetër, sepse nuk janë pak.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam shumë i kënaqur që më në fund vitin tjetër shëndetësia i kalon 3% të GDP-së, sepse ajo e vitit 2014 ka qenë për efekt të borxheve të vjetra, por nuk ju mbështes për kufizimin që vendosni me nen për fondin e rimbursimit. Përse? E para, edhe pse dolëm mbi 3% të GDP-së, ne kemi financim publik më të ulët në Europë. Kryeministri e ka thënë që shëndetësia vazhdon të jetë e nënfinancuar dhe sot është viti i gjashtë që e thotë këtë. Mos gaboju është vënë një tavan 10.5 miliardë për vitin 2019, kur për vitin 2017 ishte me 10.4 miliardë dhe nëntëmuajori është 8.6. Pra në vitin 2018 rimbursimi shkon mbi 11 miliardë dhe në vitin 2019 thoni që nuk mund të jetë më shumë se 10.5. Nëse sadopak do të rritet jetëgjatësia, atëherë sëmundshmëria do të rritet me 2-3 %, sikur asgjë të mos ndodhë. Pra 3% duhet t'ia shtosh rimbursimit për të qenë konservativ. Ne hyjmë këtë vit me 11 miliardë dhe vitin tjetër e bëjmë 10.5 miliardë, ilaçet nuk mund t'ua heqësh njerëzve mbasi ua ke dhënë. Këtu nuk ka cinizëm. Mund të mos shpërndajmë ilaçe të reja, por ilaçe të dhëna nuk mund t'i marrësh mbrapsht.

Erion Luçi – Ky ndryshim është plotësisht i justifikuar, sepse ka pasur disa audite që kanë nxjerrë jo shumë eficientë. Tani ne jemi në fazën që po vendosim një gjë arbitrare, ne jemi të interesuar ta indeksojmë, por duhet një rishikim menaxhimit të skemës.

Ilir Beqaj – Atëherë ka dy elemente që unë do t'i propozoj kur të vijë momenti i propozimeve. Në mendimin tim dhe nga eksperiencia ime në atë sektor, ka dy gjëra që mund

të ndihmojnë shumë për të ngushtuar sa më shumë hapësirat për abuzim, por edhe për mos rënduar xhepin e pacientëve konsumatorë nga përshkrimi i ilaçeve në mënyrë të tepruar.

E para, receta elektronike të shtrihet jo vetëm për rimbursim, por edhe te recetat e zakonshme. Sistemi informatik dhe firma elektronike është për të gjithë shëndetësinë shqiptare dhe nuk ka rëndësi nëse është privat ose shtet.

E dyta ka tre vjet që jemi në pritje të *truck and trace* të bankave. Është dhe një gjë e tretë, e kemi diskutuar në tetor të vitit 2013, por nuk na la FMN-ja, ndërsa sot mund t'i themi FMN-së që bëmë gabim që TVSH-në e barnave nuk e bëmë zero, por e bëmë përjashtim. Një TVSH e barnave zero e detyron farmacinë të ketë më pak hapësira për të futur mall fizik pa fatura financiare. Unë e di që TVSH-ja zero nuk ju pëlqen, sepse keni detyrime nga TVSH-ja kreditore, por besoj se ato çfarë humbim nga rrjeti i rimbursimit dhe nga xhepi i qytetarit, nëse e lëmë zero vetëm te barnat dhe nuk prekim shërbimet mjekësore, sepse në shërbimet mjekësore futen shumë më tepër TVSH kreditore, këto gjëra mund ta zgjidhin gjënë shumë mirë. Unë do ta propozoj TVSH-në e barnave si deputet individual, pastaj gjykojeni vetë nëse e merrni apo jo parasysht.

Te pjesa e paketës fiskale duhet të diskutojmë veç e veç, por, meqë kemi ndërtuar, unë personalisht e quaj të papranueshme, me gjithë rezervat që kam për uljen nga 15% në 8% të të ardhurave nga dividendi, që t'i jepni fuqi prapavepruese. Në këtë rast kjo është amnisti dhe nuk është politikë e re. Madje, sipas meje, duhet të hyjë në fuqi në janar të vitit 2019, që do të thotë se kur të ndahet fitimi i vitit 2019 në vitin 2020, atëherë duhet të tatohesh 8%. Pse duhet të tatohesh sot me 8% për vitin 2016? Po ai që e ndau me 15%? Ne vazhdojmë të ndërtojmë më shumë pabarazi, madje besoj se një pjesë e tyre janë kompani të huaja dhe një ditë kanë për të ikur nga Shqipëria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk po flas për kompanitë që do të ikin nga Shqipëria, por po flas për fitimin që do të ikë nga Shqipëria. Një pjesë e këtij dividendi, që do të merret, do të shkojë te kompania mëmë.

Erion Luci - Ne nuk i detyrojmë dot të qëndrojnë.

Ilir Beqaj – Sigurisht, por çfarë po bëjmë ne? Ne po lehtësojmë daljet nga kompania, ndërkohë që duhet të nxisim riinvestimet në kompani. Hajdeni të bëjmë maksimumin, që këto kompani të qëndrojnë sa më shumë, duke investuar dhe riinvestuar! Pra, ne lehtësojmë daljet dhe...

Erion Luci - Këtë do ta diskutojmë në orën 15:00.

Ilir Beqaj – A e dini pse nuk e kemi në orën 15:00? Sepse ai është ligj i veçantë, por i gjithë buxheti, zoti Vullnet, është ndërtuar mbi të ardhurat hyrëse dhe dalëse. Të ardhurat hyrëse janë 4,5 miliardë për këtë gjë dhe prandaj po e diskutojmë në parim. Megjithatë, në qoftë se ju e gjykoni se kjo është parakohshme, atëherë vazhdojë në orën 15:00. Faleminderit!

Fran Ibrahim - Unë kam dy gjëra shkurtimisht, meqenëse zoti Beqaj përmendi tatimin e dividendit. Personalisht jam pro zotit Beqaj, sepse normalisht lehtësimi i biznesit sjell zhvillim ekonomik.

Së dyti, ne duhet të jemi realistë se sa taksohet 100-lekëshi, sepse normalisht kemi 15% tatimfitimin dhe 15% janë investitorë, që do të tërheqin paratë e tyre. Pra, në qoftë se ne jemi 3 aksionerë që kemi investuar disa para dhe unë, si aksioner, dua të tërheq para që të jetoj me familjen, sipas zotit Beqaj, nuk duhet t'i tërheq këto para.

Ilir Beqaj – Ti mund t'i tërheqësh, por vetëm 15%.

Fran Ibrahim – Ky është mendimi juaj, sepse, personalisht, e falënderoj ministrinë që ka marrë këtë nismë. Kjo është politikë e re, të cilën ne duhet ta shikojmë me kujdes, sepse, duam apo nuk duam ne sot, në çdo shtet është aksioner te një kompani private pa investuar asnjë lek. Pra, nëse ne nuk do të përdorim politika ekonomike për t'i afruar investitorët, veçanërisht investitorët e huaj, atëherë çfarë zhvillimi do të kemi? Meqenëse infrastruktura për mua është një ndër pikat kryesore për zhvillimin ekonomik të vendit dhe planifikimi për vitin 2018 më duket se ishte 15 miliardë lekë, në mos gabohem, unë dua të di: sa ka qenë fondi për vitin 2018 dhe sa është rritur për vitin 2019? Këtu po flas për diferencën, meqenëse për vitin 2019 është planifikuar 15 miliardë.

Së dyti, ju thatë se numri i papunësisë nga 12,9%, që është konkretisht sot, mendohet të shkojë në 12 pikë ca. Atëherë, çfarë politikash do të ndiqen për uljen e kësaj papunësie dhe në çfarë fushe mendoni se do të rrisni punësimin për të bërë këto politika? Nuk ka rëndësi nëse do të jenë punësime në sektorin shtetëror apo privat. Pra, cilat janë politikat që ju keni munduar për uljen e papunësisë?

Së treti, mbase të tjerët e kanë ndjekur nëpërmjet medieve, por unë nuk e kam ndjekur dhe me këtë rast dua t'i bëj një falënderim të veçantë ministrisë për rritjen e pagave, sidomos për mjekët, të cilët janë personat që duhen vlerësuar, janë heronj të heshtur, të cilët rikthejnë në jetë njerëz, sepse gjithmonë i kemi paragjykuar si shoqëri. Me sa dëgjova do të ketë rritje të pagave për mjekët dhe policët e burgjeve, sepse edhe kjo ka qenë pjesë e harruar. Pra, sa do të jetë rritja e pagave për këto institucione?

Së fundi, ju thatë se investimet e huaja do të jenë shumë të mëdha për vitin 2019. Sa mendohet se do të jenë afërsisht këto investime? Faleminderit!

Erjon Luçi - Po e nis me papunësinë si strategji dhe kemi nxjerrë këto shifra për infrastrukturën. Papunësia është një ndër prioritetet, për të mos thënë prioriteti kryesor, që ka qeveria. Fokusi kryesor, përtej nxitjes së drejtpërdrejtë nëpërmjet investimeve apo sektorëve që kanë një intensitet të punësuarish, është përmirësimi i sistemit të trajnimeve dhe shkollave profesionale. Duke filluar nga ky vit do të hapen 6 qendra multifunkionale, të cilat do të rrisin këtë kapacitet trajnues, ndërkohë që vitin e ardhshëm do të hapen 8 të tjera. Shifrat duhet t'i saktësoj, sepse nuk i kam, por ka një krah jo të vogël investimesh, si dhe ka edhe një krah tjetër të përmirësimit të kurrikulës dhe të aktivizimit të zyrave të punës. Gjithashtu, kemi edhe aspektin e vendosjes së disa targeteve lidhur me ndihmën ekonomike që të skanojë ata njerëz, të cilët mund të aktivizohen jo me forcë, por, të paktën, të detyrohen, në aspektin pozitiv të fjalës, të kalojnë një cikël trajnimi, sidomos tek ato profesione që janë më të kërkuara. Mundësisht të bëhet edhe njëfarë rialokimi ndërmjet rajoneve të ndryshme. Po marr shembull Dibrën, e cila kishte nevojë për kuzhinier. Unë nuk po them se kjo gjë duhet të bëhet e detyruar, por ka shumë elemente të tilla që sjellin më afër punëdhënësin dhe punëmarrësin dhe ulin papunësinë. Domethënë, ky është një ndër sektorët për të cilët ne marrim një mbështetje buxhetore, madje edhe mbështetje të huaj. Gjithashtu, edhe nga donatorë të tjerë ka pasur shumë analiza të mirëfillta, që i kanë dhënë një bazë të mirë sektorit për të ecur para, sidomos në aspektin e nxitjes sa më shumë të punësimit. Deri tani ne kemi ecur mirë dhe kjo duket edhe nga numri i zyrave të punës. Në këtë sektor ia vlen të vazhdohet me këtë ritëm. Gjithashtu, edhe vitin e ardhshëm ne do të vazhdojmë punën me qendrat multifunkionale dhe qendrat e trajnimit, kështu që ritmi i papunësisë do të bjerë.

Lidhur me mjekët, siç e thatë edhe ju, është kategoria më e rëndësishme. Një nga objektivat tanë është krijimi i njëfarë konkurrence të mjekësia, por ndoshta kjo mund të mund të diskutohet në një tjetër komision. Politika e ministrisë shkon përtej pagës për të mbajtur mjekët dhe rishpërndarjen e tyre në vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në aspektin e infrastrukturës si numër bruto nuk është se ndryshon shumë nga viti në vit. Unë po flas në aspektin e planifikimit aktual, domethënë jemi në shifrën 22 miliardë.

Vullnet Sinaj - Pra, nuk do të ketë rritje në vitin 2019?

Erjon Luçi - Domethënë në vetvete viti 2018 kishte një rritje goxha të madhe, kështu që ne do të mbajmë të njëjtin ritëm.

Vullnet Sinaj - A mendoni se do të fillojë linja hekurudhore Tiranë – Vorë – Durrës, sepse, me sa di unë, fondet janë?

Erjon Luçi - Kjo është thjesht një çështje konfirmimi. Javën e kaluar unë po prisja një grant nga BERZH-i për të vazhduar me procedurat e prokurimit dhe ecjen para të kësaj gjëje. Shpresojmë që të zgjidhet kompania.

Është e sigurt se deri vitin e ardhshëm do të fillojnë punimet.

Lidhur me investimet e huaja që përmendët, a e kishit fjalën për investimet e huaja të përgjithshme apo investimet tona të publikut?

Vullnet Sinaj - E kisha fjalën për investimet e përgjithshme, meqenëse ju thatë se do të ketë shumë investime të huaja.

Erjon Luçi - Pozitive është që, me gjithë investimet e TAP-it, siç tha edhe zoti Beqaj, ka disa elemente që mund të na bëjnë më optimistë. Ky vit, pavarësisht uljes së të dy investimeve strategjike, Statkraft-it dhe TAP-it, ka mbetur si numër shumë i mirë dhe mund të arrijë edhe në 1 miliard. Kështu, kjo do të thotë se këtë nivel ne mund ta ruajmë, sepse nuk ka qenë e përqendruar në një nivel, por ka qenë e hapur ndërmjet sektorëve. Pra, kjo është një gjë e mirë, sepse ka pasur disa sektorë, ku përfshihen edhe përpunimi, tekstilet, bankat e të tjerë. Pra, kjo gjë na bën optimistë për vitin e ardhëm, por është vështirë ta përkufizosh si të qëndrueshëm pa e parë edhe një vit tjetër, por shenjat janë të mira.

(Diskutime pa mikrofon.)

Robert Bitri – A mund të na e shpjegosh edhe njëherë formulën e shpërndarjes?

Fran Ibrahim - Formula e shpërndarjes është kjo: 80% e fondit, si transfertë e pakushtëzuar, shpërndahet në bazë të popullsisë, që do të thotë se edhe popullsia është e korrigjuar, popullsia sipas gjendjes civile dhe censusit. Pra, të dyja janë të korrektuara dhe njëra ka një popullsi 4,2 milionë banorë, kurse tjetra rreth 2,8 milionë banorë dhe ka dalë një popullsi 3,5 milionë banorë. Kjo është pjesë e formulës.

5% e transfertës së pakushtëzuar mbahet për numrin e fëmijëve sipas bashkive, dhe 15% përdoret si një ekualizim fiskal, siç e quajmë ne, në bazë të dendësisë së popullsisë. Ndërsa lidhur me pjesën e arsimit parashkollor, 60% e fondit shpërndahet sipas numrit të fëmijëve 3-6 vjeç, pra në shkallë kombëtare gjithsej janë 80 mijë në kopsht dhe 40% në bazë të numrit të edukatoreve. Edhe kjo është pjesë e ligjit dhe sipas kësaj ...

Robert Bitri – Nuk kanë të njëjtat norma edukatoret me fëmijët?

Fran Ibrahim – Normat kanë qenë të deformatuara, pasi ka pasur normë mesatare për fëmijë sipas sistemit të mëparshëm, por ka pasur edhe përjashtime, sepse në zonat rurale kishte përjashtime dhe i linin. Me këtë politikë ne kemi ulur numrin nga maksimalja 26 fëmijë, që ishte për një edukatore, e kemi çuar në 23 fëmijë, pra është ulur një masë e

konsiderueshme. Gjithashtu, kemi ulur edhe normën mesatare nga 18 fëmijë për një edukatore, e kemi lenë në 15 fëmijë.

Eduard Shalsi - Fjalën e ka zonja Piro dhe më pas zoti Sinaj.

Tatjana Piro – Pyetjet e mia janë më shumë për Ministrinë e Bujqësisë, por meqenëse ju jeni zemra e të gjitha gjërave që shpërndani investimet, dua të bëj disa pyetje. A ka planifikuar ministria juaj investime për ruajtjen dhe riparimin e digave? Në qytetin tim, në Bashkinë Lushnjë, ka tri të tilla, të cilat janë në gjendje të keqe.

Së dyti, lidhur me arsimin parauniversitar, a keni planifikuar shkolla të formimit profesional ose shkolla të industrisë së agropërpunimit, të mbetjeve të tregut, të cilat mund të përpunohen? Për shembull, qumështi që nuk shitet në gjendje të freskët mund të bëhet gjizë apo djathë e të tjera. Gjithashtu, edhe perimet që kanë mbetur pa u shitur mund të bëhen perime të thata, siç është qepa e thatë, domatja e thatë, ose mund të bëhen turshi e të tjerë me radhë.

Lidhur me muzeumet, a ka një buxhet për restaurimin e tyre, për rikonceptimin e pavjoneve të muzeut me dokumente e të tjerë? Unë jam deputete në qytetin e Lushnjës, që është një qytet me shumë vlera dhe realisht mendoj se duhet bërë shumë punë në këtë muzeum.

Pyetja tjetër ka të bëjë me rrugën që lidh Lushnjën me pjesën e autostradës, që është rruga “Sabri Kosturi”. A është vënë kjo rrugë në planin e investimeve?

Unë bëra shumë pyetje, që ndoshta mund të duken të hallakatura, por kanë të bëjnë me qytetin tim dhe janë shqetësuese. Gjithashtu, duke marr shkas nga puna që kam bërë për shumë vjet në Ndërmarrjen Pyjore Lushnjë, dua të di: a është kushtuar ndonjë vëmendje mbledhjes së argjaturave me pleh?

Faleminderit!

Eduard Shalsi –Ju do t’u përgjigjeni vetëm pyetjeve që kanë të bëjnë me ministrinë tua. Ndërkohë, lidhur me pyetjet e tjera, zonja Tatjana, mund t’ua jepni edhe këshilltarëve, në mënyrë ata t’ua japin ministrive përkatës, që të përgatitin për të dhënë një përgjigje.

Tatjana Piro – Ua kam dhënë.

Eduard Shalsi – Dakord!

Erion Luçi – Shumica e pyetjeve nuk kanë të bëjnë me ministrinë tonë, por lidhur me pjesën e digave, unë di se buxheti është i pamjaftueshëm pasi ka shumë diga. Kjo gjë kërkon edhe një studim se cilat diga do të mbahen dhe cilat jo, por mund të them se fond ka.

Tatjana Piro – Digat janë një e keqe e madhe, që ju besoj se e dini.

Erion Luçi - Ndarja nuk bëhet në këtë fazë, por në një fazë të dytë, sepse më duket se e bën Komiteti i Menaxhimit të Ujit në Kryeministri.

Unë di se disa i kanë kaluar edhe pushtetit vendor, kështu që ka një koordinim. Pra, ky është mekanizmi, por si listë nuk të ndihmoj dot për momentin.

Lidhur me shkollën e agropërpunimit, nuk jam shumë i sigurt nëse ka...

Tatjana Piro – Në Lushnjë është ai bujqësor dhe blegtoral më i madhi në Shqipëri.

Erion Luçi – Me sa di unë bujqësia do ta shtyjë edhe këtë lloj formimi, por duhet ta konfirmoj.

Kurse për mbledhjen e argjinaturave të them të drejtën ...

Tatjana Piro – Këtë e kam nga përvoja shumëvjeçare e punës sime.

Erion Luçi – Një ekspert thoshte se nuk duhet të mblidhen argjinaturat.

Tatjana Piro – Unë po them me idenë siç bëhej më parë, kurse për pjesën tjetër nuk di.

Erion Luçi – Ndoshta mund të bëjmë një sesion me grupin e Sekretariatit të Ujit, sepse ata kanë një koordinim të llojeve të argjinaturave. Kjo i përket pikërisht Ministrisë së Mjedisit, që mori gjysmë miliardi investime për vitin që vjen, kështu që mendoj se argjinaturat janë në fokusin e kësaj ministrie.

(Diskutime pa mikrofon.)

Tatjana Piro – Siç e thashë, këto nuk janë pyetje për ministrinë tuaj, por meqenëse ju jeni ministria qendrore, e cila ndan buxhetet, mendoj se do të ishte shumë mirë t'i kishit në konsideratë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Luçi – Nuk është detajuar ende 5-milionëshi shtesë, që është marrë.

Tatjana Piro – Qyteti i Lushnjës ka shumë probleme të tjera, të cilat unë i kam shkruar këtu, por nuk ishte vendi për t'i diskutuar dhe mendoj se duhen parë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Erion Luçi – Segmenti i dytë është me 220 milionë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Sikur nuk është fare lidhja rurale nëpër relacione...

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Më falni se erdha me vonesë!

Nga të dhënat që kam për buxhetin për 6-mujorin e parë të këtij viti, realizimi i TVSH-së nga doganat është rreth 38 miliardë.

Sa është parashikimi i TVSH-së nga doganat për gjithë vitin?

Shoh te shpenzimet shifrën 23 miliardë e 344 milionë që zë 8,3%. Këto janë vetëm interesa apo me gjithë principalin? Si e llogarisni ju në shtet, se në privat e ndanim interesat plus principalin? Si merret kjo, tek e tek apo të dyja bashkë?

Pse nuk janë realizuar shpenzimet për subvencione? Ju thoni se në fund të vitit 2018 investimet janë në nivelin 616 milionë lekë dhe të realizuar janë 67,9%. Rreth 291 milionë lekë janë të porealizuara.

Edmond Leka - Faleminderit!

Teksa po shihja transfertat e pakushtëzuara për bashkitë, kisha një pyetje për Franin. Dihet se me zhvillimet që kanë marrë qytetet tona kemi investime të mëdha dhe kemi shtim të ndriçuesve në qytet. Duke pasur parasysh se detyrimet që kanë pasur bashkitë në vite sa po vjen e po rriten shumë. Konkretisht në bashkinë e Vlorës detyrimi ndaj OSHE-së sot është rreth 700 milionë lekë.

Si është parashikuar të shlyhen këto detyrime?

Nëse nga transferua e pakushtëzuar, nga granti, qeveria arrin t'i mbajë bashkisë këto borxhe të prapambetura, si e keni menduar këtë?

Fran Brahimi – Detyrimet e prapambetura, që aktualisht përbëjnë një stok në shkallë kombëtare rreth 7,1 miliardë lekë, do t'i përballojnë të gjitha bashkitë. Buxheti i shtetit përballon vetëm ato detyrime që rrjedhin nga investimet që ka bërë buxheti i shtetit në bashki, për shembull Fondi i Zhvillimit të Rajoneve. Madje bashkive u është kërkuar para një viti, si dhe gjatë këtij viti një plan 3-vjeçar se si, sa, kujt dhe kur do t'i paguajnë. Pra, të gjitha detyrimet i ka deklaruar disa herë ministri i Financave, që janë si rrjedhojë jo e këtyre bashkive, sepse kryesisht vijnë nga ish-komunat. Pra, bashkitë të gjitha detyrimet do të përballojnë nga pushteti vendor?

(Diskutime pa mikrofon)

Erjon Luçi – Pritshmëria e TVSH-së për fundin vitit është 144 miliardë...

(Diskutime pa mikrofon)

Kam frikë se nuk i kam të ndarë këtë të doganës, por mund ta saktësoj.

(Diskutime pa mikrofon)

Interesat janë interesa. Principali është poshtë *repayment*... është ripagesë

(Diskutime pa mikrofon)

Principali i huaj, se principali i brendshëm është pjesa që ciklohet vit për vit ose ripaguhet, varion nga 250 e lart, po mund të shkojë edhe 300. Për shembull, vitin tjetër është 300 e ca milionë. Pra, ka arritur nivele relativisht të larta, sepse tani fillojnë e maturohen edhe

kreditë koncesionare të viteve të para të tranzicionit, që është një nga arsyet se pse ne po dalim edhe me eurobond, që nuk është për të rritur borxhin, por është thjesht për të mbajtur mbipagesën ose zëvendësimin e borxhit me borxh komercial, por përsëri me terma të mira.

Shpenzimet për subvencionet mund të kenë mbetur prapa kryesisht prej subvencionit të ujit, që siç e thashë edhe pak më parë, ne e kemi fokusuar pak më shumë te pjesa e performancës që do të shkojë për investime. Kështu që ajo është pak e vonuar dhe ndoshta ajo tregon se nuk është në kohë, sepse është gati 1 miliardë, janë shpërndarë 600 dhe ka mbetur edhe 400 milionë pa u shpërndarë.

Vullnet Sinaj – Ndoshta është hera e parë që mendoj se mund të jap një kontribut të drejtpërdrejtë nga eksperiencia ime nga biznesi. Ky buxhet është ndryshe nga ato bilancet që bëjnë ndërmarrjet private, është një buxhet që tregon se nga vijnë të ardhurat: vijnë nga TVSH-ja, nga tatimet, nga renta minerare, nga sigurimet dhe merr parasysh të gjitha shpenzimet.

Unë në këtë buxhet nuk shoh se cilët janë taksapaguesit më të mëdhenj dhe çfarë parashikon Ministria e Ekonomisë dhe e Financave për t'i forcuar këta, nuk shoh një rikthim mbrapsht të një investimi të një nga këto biznese që i sjell shtetit gjithë këto të ardhura. Pra, ky buxhet është një administrim i të ardhurave, kurse pjesën e rikthimit, që të kemi të ardhura më tepër në buxhetin e vitit 2020, nuk e shoh fare. Prandaj nuk të pyet kot se sa është TVSH-ja e mbledhur në dogana.

Në qoftë se TVSH-ja e mbledhur në dogana është 100 milionë lekë, do të thotë se nga taksat, nga lekët në xhepat e shqiptarëve kanë ikur jashtë Shqipërisë 500 milionë lekë, sepse ajo presupozon se është 20% e të ardhurave së vlerës së mallit në doganë dhe unë nuk shoh në këtë projektbuxhet se sa i ka dhënë rëndësi qeveria eksportit.

Pra, të mbështesim një buxhet me të ardhura nga TVSH-ja në dogana, pra nga lekët që dalin nga xhepat e shqiptarëve dhe kur bie fjala tek eksporti, thuhet vetëm tre rreshta: “Eksporti është rritur me kaq...”.

Çfarë bëhet për ta rritur këtë eksport që ne jemi të gjithë të bindur që është e vetmja masë që mund të ndihmojë ekonominë e shqiptarëve?

Do të thosha të njëjtën gjë edhe për turizmin. Nuk shikoj në këtë projektbuxhet një relacion apo një analizë se çfarë të ardhurash ka sjellë turizmi.

Qeveria shqiptare ka bërë investime të rilindja urbane. Janë bërë investime të papara për të rritur turizmin, por nuk shoh asgjë në relacion se janë rritur këto të ardhura, si kanë ndikuar këto të ardhura të turizmit në ekonomi.

Tjetra që doja të diskutoja është për investimet për buxhetet e bashkive.

Bashkitë kanë dy të ardhura, kanë të ardhurën nga granti i pakushtëzuar që jep qeveria dhe kanë të ardhurua nga taksat e tyre vendore.

Taksat vendore të bashkive kanë dy mundësi të ardhurash, taksat nga biznesi i vogël dhe mbledhja e taksave nga shitblerja e pronave. Granti që i jep qeveria bashkive merr parasysh si bazë numrin e popullsisë dhe numrin e nxënësve.

(Diskutime pa mikrofon)

... nejtse, se ka bashki që janë totalisht rurale, totalisht malore ...

(Diskutime pa mikrofon)

... dakord, sepse nuk kam qenë.

Pra, këto ishin problemet dhe unë do të thosha se nisur nga ideja për zhvillimin ekonomik të këtij vendi që ka dhënë Kryeministri i Shqipërisë me zhvillimin urban të qyteteve për rritjen e turizmit dhe me shpërblimin që ka vënë për lindjet e reja, po të kisha në dorë do të shtoja diçka te ky buxhet. Numri i shqiptarëve që kemi pasur në vitin 2017 është me i ulët se numri i shqiptarëve që kemi në vitin 2018, sepse po largohen dhe mbajta e shqiptarëve do të na rriste konsumin në vend dhe do të ishte një tregues i vërtetë i ekonomisë, kështu që ai është i vetmi person që jep ide, kurse ministria juaj mban shifra dhe llogari.

Ide biznesi apo ide të zhvillimit ekonomik tuajat si ministri unë nuk shoh në këtë projektbuxhet dhe kjo është vërejtja ime. Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Fran Ibrahimi– Shumë shkurt, sepse janë pika të vlerësuara në aspektin e përshkrimit, sidomos të efekteve të turizmit është shumë e saktë, për të thënë se duhet një analizë pak më e thelluar. Në aspektin e lidhjes së të ardhurave me shpenzimet është parim bazë i buxhetit që nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë, sepse pastaj bëhet shumë lobiste, le të themi. Ky është një parim për të cilin ne mund të diskutojmë më gjatë, por nuk është e njëjta gjë se si funksionon, sepse ka shumë funksione publike si mbrojtja, socialja, rendi, të cilat nuk kthehen një më një.

Për nxitjen e eksporteve keni prapë shumë të drejtë, se ka nevojë për një theks më të fortë. Sektori që merr vëmendje është bujqësia.

Nëse ka atë raport që thatë ju për eksport-importet, që është duke u përmirësuar, sidomos në bujqësi, pjesa e bujqësisë është ndër më kryesore. Importet kryesore ne i kemi në sektorin e bujqësisë, përtej pjesës së ndërtimit, por ajo është një bilanc pozitiv.

Fokusimi te bujqësia, përtej faktit që ajo lidhet me pjesën e turizmit në aspektin e agroturizmit, është një ndër sektorët që shkon me frymën e përmirësimit të këtij raporti të eksport-importeve.

Objektivat afatgjata zhvillimore nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë reflektuar në buxhet, por gjithmonë ka vend për përmirësim.

Eduard Shalsi – A ka kush diçka për të shtuar? Nuk ka.

Atëherë, duke ju falënderuar, rishihemi bashkë këtu në orën 3 për të diskutuar për paketën fiskale.

Fran, të lutem, një përmbledhje koncizë për periudhën 2015-2018, pikat e forta dhe pikat e dobëta, domethënë çfarë mbetet për t'u bërë. Bie fjala, me pyjet dhe pushtetin vendor kemi një gropë shumë të madhe. Na duhet të pranojmë se ka një problem të madh. Këtë nuk e duam me urgjencë. Përpunoje si informacion që ne këtë kemi disa pika, që ku ishin në 2015 dhe ku jemi sot. Unë personalisht besoj se reforma territoriale është një supersukses, por ca gjëra janë shpejt dhe ca gjëra duan edhe pak kohë që të vihen në dukje.

Ndërkohë, Erjon, mbetet kjo pjesa e mënyrës skematike të dy inceneratorëve, për Elbasanin dhe Fierin.

Kemi pastaj pjesën e kreditimit të bujqësisë. Çfarë financimi kemi nga bankat e nivelit të dytë? Çfarë financimi kemi nga sektori financiar jobankar në mënyrë që të bëjnë disa kalkulime dhe të themi se ndoshta sugjerimi i propozuar një apo dy vjet më parë për të financuar interesin e institucioneve të ndryshme apo për të ndërhyrë në institucione të tilla jo banka financiare për të rregulluar marzhet mund t'i japë një impuls tjetër bujqësisë?

Pra, është hedhur një hipotezë, që nuk mund të jetë një fondacion me 7%, një me 12%, një tjetër me 15%, një me 19%, një me 22% në territorin e Shqipërisë, por duhet parë nëse është i saktë konstatimi apo jo.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA